

Datë: 11.12.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2024” të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi Kopësht dhe Cerdhe e Integruar, në rr.”Muharrem Caushi”,Njësia Strukturore KA/208”

Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shkollës 9-vjecare, në rrugën “Muharrem Caushi”,Njesia Strukturore KA/253”.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shtigjeve në disa objekte historike kulturore”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 71247000-1, Mbikqyrja e Punes se Ndertimit.

Vlera e fondit limit: 6,140,136.89 (gjashtë milion e njëqind e dyzet mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi Kopësht dhe Cerdhe e Integruar, në rr.”Muharrem Caushi”,Njësia Strukturore KA/208” me fond limit: 1,655,854.11 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër pikë njëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shkollës 9-vjecare, në rrugën “Muharrem Caushi”,Njesia Strukturore KA/253” me fond limit: 3,434,015.10 (tre milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e pesëmbëdhjetë pikë dhjetë) lekë pa tvsh.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shtigjeve në disa objekte historike kulturore” me fond limit: 1,050,267.68 (një milion e pesëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi Kopësht dhe Cerdhe e Integruar, në rr.”Muharrem Caushi”,Njësia Strukturore KA/208”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8 (kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP 2.2.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *Shënim:* Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

- b. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkues për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qene se kjo procedure prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbim mbikqyrje për të deshmuar përvojën e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi:

- NP-1 Punime gërmimi në tokë.
- NP-2 Ndërtime civile dhe industriale.
- NP-7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës , vepraq kullimi dhe vaditje
- NP-11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
- NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-8 Ndertime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
- NS-12 Impiante teknologjik, termik dhe të kondicionimit.
- NS-14 Impiante të brëndshme , elektrike, telefoni , radiotelefoni TV etj.
- NS-18 Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin e mbikqyrjes duhet të zotërojë licensën profesionale me pikat e sipërpermendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

3. Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjetë)** personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per minimumun 3(tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:
 - 3.1 Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumin 3 (tre) muajt te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
 - 3.2 Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për minimumin 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;

- 1 (një) inxhinier Hidroteknike;
- 1 (një) inxhinier Elektrik;
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) arkitekt
- 1(një) inxhinier mekanik;

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

5.Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar për:

-1 (nje) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim").

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin“, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrefikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

- Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma (b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237,

datë 18.02.2010 *Për sigurinë dhe shëndetin në punë“ , sipas të cilit: Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.*

1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave . *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").*

Argumentimi: Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjes të pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

Shenim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 dhe 5, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka lëshuar këto dokument.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018/45001-2023, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018/45001-2023.
- d) Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.
- e) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë në Saldim EN-ISO 3834-2:2021 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën EN-ISO 3834-2:2021.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të Operatoreve të suksesshem do t’u kërkojë ofertuesve të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 10 dhe 11 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve do të jete kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shkollës 9-vjecare, në rrugën “Muharrem Caushi”, Njesia Strukturore KA/253”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8 (kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP **2.2.**

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. *Shëmin:* Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

- b. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet,të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme, te deklaruarra ne fazen e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: kontratën baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontraten e nenkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nenkontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate sherbim mbikqyrje per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për **“Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”**, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- NP-1 Punime gjermimi në tokë.
- NP-2 Ndërtime civile dhe industrial.
- NP-7 Ujësjetës, gazsjellës, vajsjetës, vepra kullimi dhe vaditje.
- NP-11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
- NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-8 Ndertime parafabrikat me beton te armuar, struktura metalike dhe druri
- NS-12 Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.
- NS-14 Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS-18 Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin e mbikqyrjes duhet të zotërojë licencën profesionale me pikat e sipërpermendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

3. Një punësim mesatar i të paktën 12 (dymbëdhjete), për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimumin 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
 - 3.1 Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumin 3 (tre) muajt të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
 - 3.2 Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për minimumin 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në

këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier Hidroteknike;
- 1 (një) inxhinier Elektrik;
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) inxhinier Mekanik;

Staf mbështetës:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profil strukturist;
- 1 (një) Arkitekt;
- 1 (një) inxhinier Elektronik;

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

5. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar për:

-1 (nje) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim”).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin“, *ku citohet se: ”Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.*

- Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").*

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 41, pika 4, gërma (b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 *Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.*

1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave . *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").*

Argumentimi: Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjes te pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

Shenim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 dhe 5, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punes, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin qe ka lëshuar kete dokument.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet

- e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
 - Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018/45001-2023, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018/45001-2023.
 - Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.
 - Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë në Saldim EN-ISO 3834-2:2021 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën EN-ISO 3834-2:2021.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të Operatoreve të suksesshem do t’u kërkojë ofertuesve të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 10 dhe 11 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve do të jete kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shtigjeve në disa objekte historike kulturore”.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojces 8 (kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP 2.2.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *Shënim:* Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të

dorëzohet vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbim mbikqyrje për të deshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:
- NP – 1 Punime gërmimi në tokë.
 - NP - 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
 - NP – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisi
 - NS – 6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
 - NS – 18 Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin e mbikqyrjes duhet të zotërojë licensën profesionale me pikat e sipërpermendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

4. Një punësim mesatar i të paktën 7 (shtatë) personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimumin 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- 4.1 Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumin 3 (tre) muajt të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- 4.2 Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për minimumin 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).*

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar, si më poshtë:

- Ing. Ndërtimi
- Ing. Topograf/Gjeodet/Markshajder
- Ing. Mjedisi

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

5.Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar për:

-1 (nje) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej

Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim").

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 41, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, "*Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin*", ku citohet se: "*Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrefikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit*".

- Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me certifikatë "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë*" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë"*)."

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 4, gërma (b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", sipas të cilit: "*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*".

1 (një) punonjës i pajisur me certifikate "*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*" e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave . (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave"*).

Argumentimi: Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjës te pajisur me certifikate "*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*".

Shenim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 dhe 5, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punes, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin qe ka lëshuar kete dokument.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018/2023, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.
- Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te sipercituar).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të Operatoreve të suksesshem do t'u kërkojë ofertuesve të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 10 dhe 11 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet perkatese vertetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

